

Smittskydd Skåne

Meticillinresistent Staphylococcus aureus (MRSA)

Informacion për pacientin. Fletë e mjekëve për mbrojtje ndaj infeksioneve.

Ç'është MRSA?

MRSA domethënë meticillinresistent *Staphylococcus aureus*. MRSA domethënë se stafylokoket janë rezistente ndaj disa llojeve të antibiotikut. Përndryshe, ato nuk dallohen nga stafylokoket, antibiotikët e ndjeshme të zakonshme.

Staphylococcus aureus janë baktere të cilat zakonisht janë në lëkurë dhe mukozë, pa shkaktuar ndonjë shqetësim. Është e zakonshme të jesh **bartës** i këtyre baktereve, pa qenë i sëmurë. *Staphylococcus aureus* ndonjëherë mund të shkaktojë infeksione të cilat duhet të trajtohen, për shembull infeksione të plagëve, lungë, impetigo (lia e derrit).

A ka rreziqe me MRSA?

MRSA nuk shkakton infeksione të tjera, por ato mund të jenë të vështira të trajtohen. Rreziku është se mund të merr më shumë kohë të shërohesh dhe ato antibiotikë të cilat duhet të përdoren, kanë më shumë pasoja anësore. Ekziston, po ashtu, një rrezik që bakteret rezistente mund të përhapen në institucionin e mjekësisë, ku shumë pacientë janë veçanërisht të ndjeshëm nga infeksioni, ku përdoret antibiotiku me shumicë. Kjo vlen sidomos në spitale jashtë vendit, ku MRSA është më e zakonshme se këtu.

Si infekton MRSA?

Një person i cili është vetëm bartës i infeksionit MRSA, rrallëherë ndodhë që t'i infektojë të tjerët. Rreziku i infektimit shtohet nëse ke infeksione në lëkurë, plagë që vështirë shërohen ose nga ato rrjedh lëng dhe ke ekzemë. Këto gjendje quhen **faktorë rreziku** i shpërndarjes së infeksionit. Si faktorë rreziku llogariten edhe disa sëmundje kronike të lëkurës si dhe stomi (ndërrhyrje kirurgjikale për zbrazjen e jashtëqitjes) dhe sondë (instrument për zbrazjen e fshikëzës), të cilat kalojnë përmes lëkurës dhe mukozës. Në ose mbi këto rreziqe ka shumë baktere. Një MRSA-bartës që ka faktorë të rrezikut për shpërndarje të infeksionit, mund t'i infektojë të tjerët brenda familjes, në parashkollë, me rastin e kontaktit me shtazët, në rast kontakti me trup kur ushtron ndonjë sport, ose në lokale të ushtrimeve gjimnastikore. MRSA infekton personat e tjerë përmes duarve, dhe mund të ngecë në gjësendet e mjedisit, për shembull në doreza dhe qilim/tapet ushtrimi. Shpërndarja e infeksionit, po ashtu, mund të ndodhë edhe në spital, në kujdesin për pleqtë dhe në mjedise të tjera mjekësore.

A mund të zhduket MRSA?

Është e zakonshme që MRSA pas një kohe nuk mund të konstatohet përmes provave. Koha varion nga disa muaj në disa vite dhe mund të jetë e vështirë të parashikohet. Mjeku përgjegjës i MRSA bashkë me mjekun e mbrojtjes ndaj infeksioneve, vlerëson se kur nuk ka më nevojë të bëhen kontrollime ose t'i përmbahesh ndonjë regjimi të veçantë të MRSA. Ky vlerësim mund të bëhet kur MRSA nuk gjë në më në provat e marra, së paku tre herë të një pas njëshme, së paku gjatë një viti.

Çka duhet të kesh parasysh

- Higjiena e mirë e duarve është gjëja më e rëndësishme, për të shmang infeksionin. Laj duart me sapun të lëngshëm.
- Ti mund të shoqërohesh si zakonisht me të tjerët, për derisa je vetëm bartës i MRSA, nëse ti nuk ke rreziqe të faktorëve të përhapjes së infeksionit.
- Nëse ke faktor të rrezikut për përhapjen e infeksionit, shtohet rreziku që t'i infektosh të tjerët. Në këtë rast është e rëndësishë së veçantë higjiena e mirë. Laj duart me kujdes. Përdor peshqirin tënd personal dhe artikuj të tjerë banje. Bë dush në vend që të lahesh në vaskë ose në pishinë. Plagët i mbështjellë me fashë dhe e ndërron fashën nëse depërton lëngu përtej fashës nga plaga. Nëse ke sondë, duhet ta kesh atë nën rrobat. Laj duart pasi që të kesh pasur kontakt me plagën ose me sondën.

Smittskydd Skåne

- Kur ke infeksion në lëkurë, ke plagë që shërohen vështirë ose ke plagë nga të cilat rrjedh lëng ose ke ekzemë, nuk duhet të marrësh pjesë në aktivitete sportive ku kontakti me trup është i shpeshtë, ose të shfrytëzosh lokale të përbashkëta ushtrimi ose gjimnastike.
- Nëse ke faktor rreziku për përhapjen e infeksionit, është me rëndësi higjiena e mirë e duarve kur të kesh kontakt me shtazët, pasi që shtazët mund të bëhen bartës të MRSA.

Këshilla të veçanta dhe rekomandimet

- Personeli ose studentët e mjekësisë dhe të kujdesit, nuk duhet të punojnë, nëse ata kanë faktorët e rrezikut për përhapjen e infeksionit. Në njësitë mjekësore me pacientë posaçërisht të ndjeshëm, kërkohet përveç kësaj, që MRSA duhet të tregoj përmes provave se personeli mund të punojë në mjekësi.
- Fëmijët, në përgjithësi, mund të shkojnë në parashkollë dhe të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet. Ndërkaq, nuk duhet të shkojnë në parashkollë, nëse ata kanë një infeksion të lëkurës, kanë plagë që shërohen vështirë ose nga ato rrjedhë lëng ose kanë ekzemë.
- Në rast se punon me shtazët, është me rëndësi që të mos infektohen shtazët. Këshilla jep mjeku i mbrojtjes ndaj infeksioneve së bashku me veterinarin e qarkut.

Rregullat e përmbajtjes të cilave duhet t'u përmbahesh sipas Ligjit mbi mbrojtjen ndaj infeksioneve.

- Ti duhet të vish në vizitë sërish dhe të japësh prova, të parapara të nevojshme nga mjeku.
- Ti duhet të bashkëpunosh për të gjurmuar infeksionin. Kjo domethënë, të japësh informacion që personeli mjekësor të mund vlerësojë, kur, ku dhe si je infektuar dhe mos ke infektuar dikë tjetër.
- Ti duhet të rrëfesh për infeksionin tënd MRSA, kur të mjekohesh, kur t'i mjekosh dhembët dhe kur të kesh kujdes mjekësor të këmbëve. Kjo vlen edhe nëse ke mjekim personal dhe përkujdesje në një banim apo edhe në shtëpi. Nëse ke ndihmë, vetëm për të blerë gjërat, për të pastruar, ndarjen e ilaçeve ose për të dalë në shëtitje, në shumicën e rasteve të tilla, nuk ke nevojë të tregosh për infeksionin tënd MRSA.
- Nëse ke faktor rreziku për përhapjen e infeksionit, duhet të rrëfesh për infeksionin tënd MRSA, në rast shpimi për varje stolie, tatuazhi, masazhi, mjekim jo mjekësor të këmbëve e trajtime të ngjashme të lëkurës ose të mukozës. Ti, po ashtu, mund të presësh me një trajtim të tillë, derisa të zhduken faktorët e rrezikut.

MRSA, sipas Ligjit mbi mbrojtjen ndaj infeksionit, është një sëmundje e rrezikut të përgjithshëm. Prandaj ti je i detyruar t'u përmbahesh rregullave të dhëna nga mjeku. Ti mund të kërkosh që mjeku i mbrojtjes ndaj infeksioneve në qarkun tënd të merr në rishqyrtim rregullat e përmbajtjes.